

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË FONDIN E SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, me objekt “Për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare”, për periudhën 01.01.2013 deri 31.12.2013, si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së nr. 75, datë 30.06.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” i ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 274/6, datë 30.06.2014, dërguar z. Astrit Beci, Drejtor i Përgjithshëm i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtëme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi u konstatua se, struktura organike e vitit 2013 është miratuar sipas kërkesave të nenit 23 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”. Kjo rregullore vijon të mbetet në fuqi, edhe pse ky ligj është shfuqizuar më datë 25.03.2013, me hyrjen në fuqi të ligjit të ri.

-FSKDSH, vazhdon funksionimin në bazë të Rregulloreve të miratuara me urdhërin nr.133, datë 6.7.2010 të ish Drejtores së Përgjithshme, ku “Organika” është pjesë përbërëse e “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe përkrahjet e punës për Drejtorinë e Përgjithshme”.

-Struktura dhe rregullorja e brendshme nuk pasqyrojnë kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, kreut II, neni 8 “Përgjegjëshmëria menaxheriale e titullarit” ku përcaktohet se titullarët e njësive publike janë përgjegjës për *“miratimin e një strukture të përshtatshme organizative dhe vendosjen e linjave të raportimit, që mundësojnë kryerjen efektive të përgjegjësisë të tyre”*

-Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, në 10 raste ka mospërputhje të kualifikimeve të kërkuara, referuar rregullores së funksionimit të FONDI-t dhe kualifikimeve faktike të punonjësve sipas pozicioneve respektive. **Për këtë është rekomanduar që:**

Nga institucioni të merren masa që të rishikohet dhe miratohet draft rregullorja e organizimit dhe funksionimit të FONDI-t, pas rikompozimit të strukturave, ku të detajohen në mënyrë të qartë përgjegjësitë në bazë të kërkesave të ligjit të ri mbi sigurimet e detyrueshme të kujdesit shëndetësor dhe ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

-të bëhen ndryshimet e nevojshme në rregullore, në përputhje me kërkesat e dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi (të konsiderohet ndryshimi i legjislationit gjatë vitit 2013), duke përshkruar me saktësi detyrat për çdo punonjës, për secilin nivel, me kualifikimet respektive.

Menjëherë

2. Nga auditimi u konstatua se ka patur mangësi në mënyrën e planifikimit të shërbimit shëndetësor referuar mënyrës së llogaritjes dhe vlerësimit të kostos, në zbatim të VKM nr. 140, datë 17.02.2010 “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”, i ndryshuar, kjo për shkak se Ministria e Shëndetësisë, nuk ka përcaktuar dhe publikuar një udhëzim të veçantë për përcaktimin e “Standardeve të shërbimit spitalor”, si bazë për llogaritjen e kostove të çdo shërbimi, detyrim që sipas VKM duhej përmbushur brenda vitit 2010, duke sjellë si pasojë që financimi i shërbimeve të kontraktuara të vijoje sipas buxhetit historik. Me VKM nr.1, datë 8.01.2014 “Për financimin e shërbimeve spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor” është shfuqizuar VKM nr.140, datë 17.02.2010, në pikën 1 të të cilit përcaktohet se: “Financimin nga skema e detyrueshme e sigurimeve shëndetësore të paketës së shërbimeve të ofruara nga spitalet publike...”, por nuk i është dhënë zgjidhje problemit të vlerësimit të kostove të

shërbimit spitalor, duke sjellë si pasojë që buxheti i vitit 2014, por edhe projektbuxheti i vitit 2015 për shërbimin spitalor të hartohet bazuar vetëm në të dhëna historike, kjo duke u mbështetur në pikën 14 të VKM. **Për këtë është rekomanduar që:**

Të intensifikohet puna e nisur gjatë vitit 2014 nga FSDKSH-ja në lidhje me hartimin dhe miratimin e kostos së shërbimeve kryesore spitalore me efekte financiare për buxhetin e kujdesit shëndetësor, kjo në plotësim të objektivave kryesorë të Institucionit, ku përcaktohet që pacientët do të marrin paketa të përcaktuara dhe të kontraktuara midis blerësit të shërbimit dhe qendrës shëndetësore, apo ofruesit tjetër të shërbimit që mund të jetë spitali publik, spitali privat. Këto paketa të jenë transparente dhe të mirëpërcaktuara, pra konkretisht çfarë do të përfitojë pacienti kur shkon në këto ofrues shërbimi.

Brenda 30.12.2014

3. U konstatua se, ka rritje të ngarkesës mesatare në banorë për çdo mjek familje, krahasuar me normën e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë, duke arritur në kufijtë maksimalë, apo dhe në tejkalim të saj (kjo referuar të dhënave të administruara nga Fondi). Gjithashtu, nga auditimi i shpenzimeve të buxhetit për Kujdesin Parësor, konstatohet se institucioni nga *administrimi i regjistrit elektronik*, sistem në të cilin regjistrohen banorët që mbulojnë mjekët me shërbim shëndetësor për çdo Qendër Shëndetësore, ka konstatuar dhe pastruar dublime të pacientëve, duke arritur deri 5 mijë të tilla në vitin 2013. Aktualisht FSDKSH administron një regjistër elektronik të banorëve, me mbi 4 milion banorë në total në rang vendi, ndërkohë që janë identifikuar me ID mbi 2.6 milion banorë në këtë regjistër. **Për këtë është rekomanduar që:**

Nga institucioni të merren masa për evidentimin e saktë të ngarkesës së mjekut të familjes, pastrimin në vazhdimësi të regjistrit elektronik të banorëve nga publikimet, si dhe bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile për përcaktimin e saktë të banorëve.

Gjithashtu, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, në rastet e ngarkesës së lartë të mjekëve, të mendohet për zgjidhje të tjera që do sjellin uljen e këtij raporti, por dhe sigurimin e një shërbimi sa më profesional për banorët, kudo që të ndodhen ata.

Menjëherë

4. Nga auditimi u konstatua se, për vitin 2013 FSDKSH-ja nuk kishte caktuar nëpunësin zbatues, sipas dhe në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 9, pika ç, ku citohet “Nëpunësi autorizues i njësisë publike bën caktimin dhe shkarkimin e nëpunësit zbatues”. **Për këtë është rekomanduar që:**

Nëpunësi autorizues të caktojë me shkresë të veçantë nëpunësin zbatues (ky i fundit në varësi dhe të raportojë para nëpunësit autorizues), si dhe të adresohen përgjegjësitë në përputhje me kërkesat e ligjit nr.10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Menjëherë

5. Nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2013 përllogaritja dhe përdorimi i “Fondit të vecantë”, është bazuar në VKA nr. 6, datë 22.01.2004 “Për dhënie ndihme ekonomike në raste fatkeqësish dhe dalje në pension”, dalë në zbatim të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, në “Kodin e Punës” dhe nenit 5 të Statutit të ISKSH. Për zbatimin e vendimit të KA, nga Drejtori i Përgjithshëm ka dalë udhëzimi nr. 478, datë 05.03.2004 “Për dhënie ndihme ekonomike në raste fatkeqësish dhe dalje në pension”, pra edhe pse ligji i mësipërm është shfuqizur dhe më datë 25.03.2013 ka hyrë në fuqi ligji i ri, ende veprohet me këto dispozita nënligjore. **Për këtë është rekomanduar që:**

Nga institucioni të merren masa që, të përgatitet projekt vendimi dhe të miratohet në Këshillin e Administrimit në mbështetje të ligjit nr. 10383, datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe

përdorimin e Fondit të veçantë”, i ndryshuar, pasi gjykojmë se VKA nr. 6, datë 22.01.2004 lë shteg për hapësira më të mëdha veprimi se sa vetë VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e Fondit të veçantë”.

Menjëherë

6. Nga auditimi i kryer për shpenzime udhëtimi e dieta brenda dhe jashtë vendit u konstatuan mangësi në plotësimin e dokumentacionit justifikues, e konkretisht:

a) *Për dietat brenda vendit*, konstatohet se autorizimet për kryerjen e shërbimit ishin të paplotësuara për datën e kryerjes së shërbimit; informacionet për shërbimin e kryer (relacioni apo informacioni) nuk i ishin bashkëlidhur dokumentave të arkës.

b) *Për dietat jashtë vendit*, konstatohet se nuk ishte hartuar dhe miratuar nga Titullari i institucionit programi paraprak vjetor për shërbimet;

- në të gjitha rastet dokumentacioni justifikues i palës pritëse, i dorëzuar në sektorin e financës, nuk ishte i përkthyer në gjuhën shqipe. **Për këtë është rekomanduar që:**

Të merren masa nga institucioni, që në vazhdimësi procedurat për dietat jashtë shtetit të bëhen konform kërkesave të VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “*Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit*”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.22, datë 10.07.2013 dhe Rregullores së Brendshme të institucionit (FSDKSH).

Gjithashtu, institucioni në vazhdimësi të plotësojë konform legjislacionit ekzistues dokumentacionin justifikues për shpenzimet për udhëtim e dieta brenda vendit.

Vazhdimisht

7. Nga auditimi i procedurave për blerjet me vlera të vogla u konstatua se, për të gjitha procedurat e realizuara me prokurimin elektronik nuk ishte bërë argumentimi e përlllogaritja e fondit limit. **Për këtë është rekomanduar që:**

Të merren masa nga institucioni, që në çdo rast të bëhet argumentimi i fondit limit për blerjet që do t’u nënshtrohen procedurave të prokurimit publik, kërkesë e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe pikës 2/d të kapitullit 6, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe Udhëzimit të APP nr.2, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit të blerjeve me vlera të vogla”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.2, datë 28.03.2013, i ndryshuar, pika 5.

Vazhdimisht

8. Nga auditimi i likuidimeve për shpenzimet e karburantit e shpenzime të tjera u konstatua se, faturat tatimore nuk ishin nënshkruar nga personi i autorizuar apo komisioni i marrjes në dorëzim, por nënshkruheshin nga ish kryetari i NJHD. **Për këtë është rekomanduar që:**

Të merren masa nga institucioni që, në çdo rast marrja e mallit në dorëzim të bëhet vetëm nga komisioni i ngritur konform legjislacionit ekzistues dhe udhëzimeve të dala në zbatim të tij.

Vazhdimisht

9. Nga auditimi i shpenzimeve të kryera për shërbimin e sigurisë dhe ruajtjes së objektit u konstatua se, dokumentacioni justifikues për këtë shpenzim nuk ishte i plotë, pasi mungonte dokumenti ku të konfirmohej marrja në dorëzim e shërbimit nga ana e FSDKSH, si dhe në kushtet e vendosura në kontratë nuk pasqyrohej qartë mënyra se si vërtetohej nëse shërbimi ishte kryer. **Për këtë është rekomanduar që:**

Të merren masa nga institucioni që, të përmirësohen kushtet e vëna në kontratë mbi marrjen në dorëzim të shërbimit të sigurimit dhe ruajtjes së objekteve nga ana e FSDKSH, si dhe konfirmimin e tij nga të dy palët nënshkruese të kontratës.

Menjëherë

10. Nga auditimi i kryer mbi shpenzimet e karburantit, të konsumuar nga automjetet në disponon të FSDKSH-së, u konstatua se ishte vepruar sipas normave të konsumit të karburantit të përcaktuara në vitin 2006 dhe 2009, po kështu edhe kronometrimet e lëvizjes së automjeteve. **Për këtë është rekomanduar që:**

Të merren masa nga institucioni për rishikimin dhe miratimin e normativave të harxhimit të karburantit dhe kronometrimet e lëvizjeve të automjeteve që disponon institucioni.

Menjëherë

11. Nga auditimi i kryer për magazinimin e mallrave dhe artikujve, u konstatua se kushtet e ruajtjes dhe siguria e mallrave dhe materialeve në ambientin e magazinës ishte problematike, pasi ambienti që përdoret si magazinë ishte i pamjaftueshëm dhe një sasi e artikujve ishin sistemuar në ambjentet e tjera që shërbenin si magazinë, të cilat ishin të amortizuar dhe me lagështirë. Për rrjedhojë, nuk kishte siguri për mirëmbajtjen e 22 artikujve me vlerë 6,150,505.65 lekë dhe 14 artikuj me vlerë 558,392 lekë, si detergjentë e materiale pastrimi, të cilët ishin sistemuar në ambiente të tjera. **Për këtë është rekomanduar që:**

Të merren masat e duhura nga ana e Institucionit për sigurimin e ambienteve të përshtatshme për magazinimin e mallrave, në mënyrë që të garantohej ruajtja dhe administrimi i vlerave materiale të ISKSH-së, por duke eliminuar mundësinë e dëmtimeve të këtyre vlerave materiale. Në pamundësi të krijimit të kushteve, duhet të minimizohen sasi të mallrave të disponueshme në institucion, nëpërmjet një planifikimi korrekt të nevojave.

Menjëherë

12. Nga auditimi i ndjekjes, sistemimit dhe kuadrimin të debi kredive, sipas Bilancit Përmbledhës të konsoliduar të FSDKSH-së, rezultoi se vijon të mbetet shqetësues arkëtimi i debitorëve të prapambetur e që përfaqësojnë detyrime “pa shpresë për t’u arkëtuar”, konkretisht në DRSKSH-Sarandë, në shumën 232,039 lekë, të cilëve nuk u dihet origjina; DRSKSH-Fier për shumën 3,324,108 lekë, për të siguruarit vullnetarë, të cilët nuk kanë paguar tarifën e detyrimit shëndetësor, detyrim ky i krijuar në periudhën 2009-2010; DRSKSH-Shkodër në shumën 681,752 lekë, e cila përbëhet nga një autoveturë dhe disa pajisje zyre, të vjedhura në vitin 2000, për të cilat është dërguar praktika e plotë për të nisur procesin gjyqësor, si dhe detyrimi për dëm ekonomik dhe kushte penale prej 326,072 lekë për një punonjëse, i verifikuar që në Dhjetor 2002; DRSKSH-Tiranë përfshin një shumë prej 1,155,293 lekë, të cilët janë debitorë të konstatuar në Tiranë për dy autovetura dhe një kompjuter, të vjedhur në vitet 1997-2001 (pa shpresë arkëtimi), për të cilët Prokuroria e rrethit Tiranë ka njoftuar pezullimin e hetimeve për moszbulimin e autorëve. **Për këtë është rekomanduar që:**

Institucioni, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, të marrë masa sipas dispozitave ligjore në fuqi për të maksimizuar arkëtimet e detyrimeve debitoare, të rezultuara gjendje në bilanc më 31.12.2013, dhe për shumat pa shpresë arkëtimi të bëjë sistemimin e tyre në kontabilitet.

Vazhdimisht

13.1 Nga auditimi i Pasqyrave financiare të konsoliduara të FSDKSH-së, rezultoi se ato nuk janë hartuar në përputhshmëri me parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara në zbatim të Standarteve të Kontabilitetit. Konstatohet se ka mospërputhje në formatimin e pasqyrave të dorëzuara nga njësitë e varësisë me bilancin e konsoliduar, por konstatuam mungesë konsistence në parimet mbi të cilat ndërtohen këto pasqyra kështu DSKSH-Tropojë, në përputhje me standartet e kontabilitetit paraqet shpenzimet për qendrat shëndetësore (bonus dhe aktivitet) mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, ndërsa të gjitha njësitë e tjera i paraqesin në bazë cash.

13.2 Nga auditimi i Bilancit Përmbledhës të konsoliduar të FSDKSH-së, u konstatua se të gjitha drejtoritë rajonale përfshirë edhe Aparatin, mbajnë kontabilitetin në formate të përpunuar

në excel. Kjo lloj praktike rrit probabilitetin e “gabimit njerëzor”, por kompromenton dhe sigurinë e të dhënave duke krijuar hapësira të ndryshimit të të dhënave në çdo kohë dhe duke mos lënë gjurmë. Institucioni është pajisur me programin e kontabilitetit ORACLE, me të cilin aktualisht nuk operohet për mbajtjen e llogarive apo menaxhimin financiar.

13.3 Nga auditimi i Bilancit Përmbledhës të konsoliduar të FSDKSH-së, u konstatua se Aktivët e Qëndrueshme të Patrupëzuara për të gjitha njësitë e varësisë përfshijnë të njëjtat elementë, që janë programet financiare aplikativ, të përdorura aktualisht nga Fondi, përveç Aparatit, i cili në këtë zë ka përfshirë edhe “Projekti i godinës + Detyra e projektit të godinës së ISKSH-së + Taksa e Rikonstruksionit të godinës së ISKSH-së”, për një vlerë totale prej 4,434,938 lekë. Efektet e këtij klasifikimi të gabuar i referohen mangësisë në përcaktimin e drejtë të vlerës së rikonstruksionit të ndërtesës por nga ana tjetër ndryshime në nivelin e amortizimit të paraqitur në pasqyrat financiare.

13.4 Nga auditimi i Bilancit Përmbledhës të konsoliduar të FSDKSH-së, u konstatuan pasaktësi në përlllogaritjen e shpenzimeve të amortizimit për Aktivët e Qëndrueshme të Patrupëzuara për DRSKSH Gjirokastër dhe DRSKSH Elbasan. Konkretisht nga DRSKSH Gjirokastër është përdorur norma prej 6% dhe nga DRSKSH Elbasan është përdorur norma prej 13%, kundrejt 20% të përcaktuar në VKM nr. 783, datë 22.11.2006. **Për këtë është rekomanduar që:**

- Institucioni të marrë masa në mënyrë që, regjistrimi në kontabilitet të bëhet bazuar në të drejtat dhe detyrimet e konstatuara, në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.

- Institucioni të marrë masa në mënyrë që sistemi Oracle të bëhet operativ dhe eficient, në mënyrë që të shmanget mbajtja e të dhënave në formate “excel”-i.

- Institucioni të bëjë saktësimet lidhur me vlerën e aktiveve që do të paraqiten në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2014, duke gjykuar për klasifikim të drejtë të zërave që përfshihen në “Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuar” apo zëri “ Investime në proces”.

- Institucioni të marrë masa të përlllogarisë saktë shpenzimet e amortizimit dhe kryerjen e sistemeve në zërat përkatës të pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2014, si dhe kryerjen e veprimeve të sistemit nga njësitë e varësisë, në përputhje me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Regjistrimet kontabël për Aktivët e Qëndrueshme të Patrupëzuara”.

Menjëherë

14. Në procedurën tenderuese me objekt “Botimet e ISKSH-së për vitin 2013”, zgjedhja e procedurës “Kërkesë për propozim” është bërë, duke mos dokumentuar argumentimin e pamundësinë, arsyet teknike, mungesën e konkurrencës, etj, kjo në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 34, pika 1, ku citohet “*Kjo procedurë nuk mund të përdoret për të shmangur procedurat konkurruese të prokurimit*”. **Për këtë është rekomanduar që:**

Nga ana institucionit në vazhdimësi të merren masa për të dokumentuar argumentimin e zgjedhjes së procedurave tenderuese në rastet e pamundësisë, arsyeve teknike, mungesës së konkurrencës, duke mos shmangur në asnjë rast konkurrencën e lirë në procedurat tenderuese.

Vazhdimisht

15. Në procedurën tenderuese “Blerje artikuj kancelarie për vitin 2013, Loti 1”, sigurimi i kontratës i paraqitur nga operatori ekonomik i shpallur fitues “Mond office” sh.p.k është paraqitur 14 ditë mbas lidhjes së kontratës, kjo bie në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, “Sigurimi i kontratës”, pika 4.2, ku citohet “*Autoriteti kontraktor kërkon sigurimin për ekzekutimin e kontratës. Shuma e sigurimit për ekzekutimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së kontratës. Formulari i sigurimit të kontratës, që është i bashkangjitur si Shtojca 17 e DST duhet të nënshkruhet dhe të dorëzohet para nënshkrimit të kontratës*”.

- nga auditimi i dokumentacionit administrativo-ligjor të operatorëve ekonomik, të shpallur fitues “Mond office” dhe “Cartoshop” rezultoi se dokumentat janë marrë në dorëzim në datën 28.08.2013 sipas procesverbalit të marrjes në dorëzim të dosjes së prokurimit, ku KVO-ja ka

verifikuar dokumentacionin e paraqitur nga këta operatorë ndërkohë që kontrata është lidhur më datën 14.08.2013. Ky veprim bie në kundërshtim me udhëzimin e APP-së “Për shqyrtimin dhe vlerësimin në prokurimin me mjete elektronike”, kapitulli “Njoftimi i Fituesit”, paragrafi i fundit ku citohet: “operatorit ekonomik të shpallur fitues, **para lidhjes së kontratës** i kërkohet të paraqesë dokumentacionin administrativo-ligjor në formë të shkruar të paraqitur në tender (origjinal ose fotokopje e noterizuar), i cili verifikohet nga KVO-ja dhe bëhet dosje”. **Për këtë është rekomanduar që:**

Autoriteti kontraktor të marrë masa që në të ardhmen, para nënshkrimit të kontratës të plotësohen dosjet me të gjithë dokumentacionin përkatës nga operatorët ekonomikë, të shpallur fitues, në zbatim të dispozitave ligjore dhe nënligjore.

Vazhdimisht

16. Në procedurën tenderuese “Blerje artikuj kancelarie për vitin 2013” u konstatua se: -përlllogaritja e fondit limit për zërin artikull “letër format A4” nuk është bërë duke u bazuar në nevojat reale të institucionit, duke e rritur me 20 % në mënyrë artificiale fondin limit, kjo në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 8, pika 5 ku citohet “Drejtuesit e të gjitha niveleve të njësisë... janë përgjegjës për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësisë të caktuara nga titullari, duke menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet”. **Për këtë është rekomanduar që:**

FSDKSH-ja të marrë masat për përlllogaritjen e saktë të nevojave për mallra dhe shërbime, kjo në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të dispozitave ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

Vazhdimisht

17. Në procedurat tenderuese me objekt:

- a) “Botimet e ISKSH-së për vitin 2013”, kontrata është lidhur në datën 30.04.2013 midis AK-së dhe operatorit ekonomik të shpallur fitues “Adel Co”sh.p.k.
- b) “Riparim, mirëmbajtje dhe vendosje pjesë këmbimi të automjeteve të ISKSH-së” kontrata është lidhur në datën 24.04.2013 midis AK-së dhe operatorit ekonomik të shpallur fitues “Alstezo”sh.p.k. Konstatohet se në kontrata nuk është përcaktuar “Mbikqyrësi i kontratës”, duke qenë në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VIII, neni 2. **Për këtë është rekomanduar që:**

Nga ana institucionit të merren masa për të përcaktuar mbikqyrësin e kontratës, në kontratat me objekt realizimin e shërbimeve dhe blerjen e mallrave, në përputhje dhe me VKM-në nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VIII, neni 2.

Vazhdimisht

18. Për të siguruar zbulimin dhe dënimin e fenomeneve abuzuese me skemën e sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor, kjo referuar gjetjeve dhe konstatimeve të bëra nga Drejtoria e Kontrollit Parësor dhe Farmaceutik, duke u përqëndruar te veprimtaria e mjekut të familjes, mjekut specialist, farmacistët dhe të siguruarit nga skema, **është rekomanduar që:**

Të përmirësohen udhëzuesit metodik të kontrollit në subjektet me kontratë me FONDI-n, si udhëzuesi metodik nr.2, datë 07.04.2006 “Për evidentimin dhe dokumentimin e kontrollit nga DKMF”, udhëzimit metodik nr.2, datë 26.10.2010 “Për kontrollin në farmaci dhe agjensitë farmaceutike me kontratë me sigurimet shëndetësore” dhe udhëzimit metodik nr.1, datë 25.10.2010 “Për kontrollin në depot farmaceutike të barnave që kanë kontratë me sigurimet shëndetësore”.

-Nga **Sektori i Kontrollit Parësor** të bëhen kontrole të koordinuara të mjekëve të përgjithshëm të familjes (MPF) me kontrollet e mjekëve specialistë, në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale;

- Të ushtrohet kontroll më i hollësishëm në QSUT dhe KMCAP, në lidhje me rekomandimet e dhënies së barnave për trajtimin e të siguruarve;
- Të harmonizohen kontrollet e plota me kontrollet tematike për rajonet që kanë tejkalim të planit të rimbursimit gjatë vitit;
- Të bëhen kontrolle paralele të rajoneve që kanë afërsisht të njëjtët tregues të rimbursimit.
- Nga **Sektori i Kontrollit Farmaceutik (farmaci/agj.farmaceutike dhe Depove)**:
- Në vazhdimësi të bëhet ndjekja e zbatueshmërisë së detyrimeve kontraktuale, si dhe vendosja e sanksioneve që parashikojnë kontratat me subjektet farmaceutike në fuqi;
- Prioritetet t'u jepet kontrolleve për subjektet farmaceutike me një vlerë rimbursimi mbi 1.5 milion lekë;
- Ti kushtohet një rëndësi e veçantë përdorimit të programit on-line "e_farmaci", hedhja saktë e të dhënave nga subjektet farmaceutike, si dhe vënia në efikasitet të programit nga të gjitha subjektet farmaceutike me kontratë me FONDI-n;
- Kontrollet të planifikohen dhe realizohen duke u nisur nga analiza të hollësishme, grumbullim informacioni më të plotë për aktivitetin e subjekteve që do të kontrollohen, duke u fokusuar në indikatorët më specifikë, me synimin e një kontrolli me raportin kosto-efikasitet pozitiv;
- Të rritet bashkëpunimi me Drejtoritë Rajonale dhe me drejtoritë e tjera të FONDI-t për përmirësimin e herë pas herëshëm të punës për saktësimin e të dhënave;
- Rritja e kontrolleve tematike, në mënyrë të tillë për të pasur influencë më të madhe kontrolli;
- Monitorimi dhe qarkullimi i barnave alternative të para në listën e barnave të rimbursueshme, sipas aneksit "A" të deklaruar nga depot importuese, me qëllim mbulimin e tregut dhe plotësimin e kërkesave të pacientëve, për medikamente, që rimbursohen 100%;
- Kontroll për barnat me rimbursim më të lartë, të cilat tregëtohen në farmacinë e QSUT-së, si dhe në farmacinë e spitaleve Rajonale, të cilat plotësojnë nevojat e pacientëve të veçantë, që trajtohen për sëmundje të Sklerozës Multiple, të sëmundjeve Endokrinologjike Pediatrike, të sëmurëve me Anemi sekondare, të sëmurëve me dializë;
- Kontroll për barnat me pullë të MSH dhe QKKB-së, si dhe korrespondimin e tyre me seri skadencën e barit;
- Kontroll për seri skadencat e deklaruar të barnave të importuara nga depot importuese me ato të deklaruar nga vetë ajo, si dhe qarkullimin e tyre.

Vazhdimisht

19. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, të vazhdojë negociimet jo vetëm me Institutin e Sigurimeve Shoqërore (ISSH), por edhe me Ministrinë e Financave, ku të kërkohet nga ISHSH të transferojë diferencën e mbetur **në shumën 215,495 mijë lekë, në llogarinë bankare të ISKSH**, si detyrime të prapambetura nga kontributet e mbledhura për sigurimet shëndetësore dhe të pa transferuara në llogaritë e FONDI-t.

Brenda 30.09.2014

20. Nga auditimi i kryer u konstatua se institucioni i FSDKSH nuk është i pajisur me certifikatën e pronësisë, por ishte regjistruar sipas dokumentit "Vërtetim hipotekor" të pronësisë nr.681, datë 04.05.2007. Gjithshtu u konstatua se, nuk është përfunduar procesi i inventarizimit të AQT në drejtoritë rajonale, në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit Publik". **Për këtë është rekomanduar që:**

Institucioni, të marrë masa të menjëhershme që të mbyllet procesi i inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe përcaktimi i drejtë i vlerës me të cilën ato do pasqyrohen në kontabilitet, si për institucionin dhe njësitë e varësisë.

FSDKSH të marrë të gjitha masat në zbatim të legjislacionit në fuqi, për tu pajisur me certifikatën e pronësisë së bashku me kartelën hipotekore të rifreskuar .

Brenda 30.12.2014

21. Institucioni të vazhdojë të ndjekë në rrugë administrative dhe ligjore dokumentimin ose lirin e sipërfaqes prej 15 m² të zënë nga shoqëria “ÇEZ Shpërndarja” sh.a, pasi pamvarësisht komunikimeve midis palëve kjo çështje nuk ka gjetur zgjidhje.

Vazhdimisht

22. Referuar konstatimit se, Drejtoria e Auditit të Brendshëm ka në strukturë 16 punonjës, nga të cilët 9 punonjës të profilin e ekonomist, 1 me profilin e jurist, 4 specialistë mjekë dhe 2 të profilin e farmacist, si dhe faktit që 1 punonjës nuk është i certifikuar, sepse është emëruar më datë 19.12.2013 në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm pranë FSDKSH-së, kjo në kundërshtim me në ligjin nr. 9720, datë 27.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar neni 19 “Audituesi... duhet të jetë paisur me certifikatën “Auditues i brendshëm sektorin publik”...”, **është rekomanduar që:**

Që të rritet efienca e punës së kësaj Drejtorie dhe për të patur rezultate që do të ndikojnë në përmirësimin e punës së njësive në varësi të FONDI-t, por dhe për tu adresuar në problematika ku strukturat e tjera të auditimit e kanë të pamundur të kontribuojnë për shkak të mungesës së kapaciteteve (mjekë dhe farmacistë) do të rekomandohet që nga institucioni të gjykohet me kujdes raporti mjek/farmacist dhe profesione të tjera brenda kësaj strukture.

Do të rekomandohet që në të gjitha rastet e përfshirjes së punonjësve në këto struktura të mbahen parasysh kërkesat e ligjit nr. 9720, datë 27.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar.

Menjëherë

23. Gjatë vitit janë kryer ndryshimet e planit vjetor të vitit 2013 me miratimin e Titullarëve me shkresat nr.2317 prot të datës 30.09.2013 dhe nr.2525 prot të datës 17.10.2013. Janë hequr nga plani i auditimit të vitit 2013 me argumentimin që janë subjekte me risk të ulët 13 qendra shëndetësore, në rrethet Berat, Tropojë, Gjirokastrë, Shkodër dhe Vlorë dhe janë zëvendësuar me auditimet tematike me bazë risku në FSDKSH, DRSKSH Fier, QSH Cërrik, Paskuqan, Kukës dhe Drejtoria Spitalore Krujë, por pamvarësisht se ky ndryshim është në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhrin Ministrit të Financave nr. 69, datë 29.09.2010, nuk konstatuam plotësi të kësaj vendimmarrje me dokumentacion dhe analizë të riskut që të ndryshojnë drejtimit e auditimit.

Problematikat me të mëdha janë konstatuar në auditimin e marrëdhënieve të FSDKSH-së me subjektet e kontraktuara, të lidhura këto me pasaktësi në mbajtjen faktike të inventarëve, mos penalizim në vlerën e duhur kur janë shkelur afatet ligjore në lidhje me raportimin e subjekteve farmaceutike, ekzistencës së të metave që kanë raportet e supervizimit lidhur me menaxhimin e aktiveve, analizën në detaje të rimbursimit të barnave, zbatimin e detyrave të lëna nga supervizimet e realizuar për subjektet e kontraktuara, shkeljeve lidhur me plotësimin e regjistrave profesional nga mjekët e familjes si ai i urgjencës, i fëmijëve, i vizitave në shtëpi, etj, mosplotësimin e recetave të veçanta për çdo diagnozë. Veprimet e mësipërme janë kryer duke shkelur udhëzimin e Ministrisë së Shëndetësisë nr. 166, datë 25.07.1996 “Për përshkrimin e barnave narkotike dhe psikotrope”, mos menaxhimin si duhet i të ardhurave dytësore, mos informatizimin e kontabilitetit, mos përdorimin dhe implementimin e programit “Kosto Spitali”, për të cilët, **është rekomanduar që:**

-Institucioni të marrë masa për hartimin e një metodologjie, që do të çojë në vlerësimin real të zonave me risk, për t'u larguar nga praktika e vendosjes mbi baza subjektive për subjektet që planifikohen për auditim

-Përqëndrimi i punës audituese në fushat ku FONDI ka superioritet në kapacitetet audituese, ku është e pamundur të mbulohen nga audituesit e jashtëm të institucionit.

Brenda datës 30.09.2014

24. Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, të ndjekë problematikën e konstatuar për medikamentet e skaduar në Spitalin e Durrësit sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Vazhdimisht

25. Nga institucioni të ndiqet në vazhdimësi procesi gjyqësor për shpërblimin e dëmit nga 19 persona, në vleftën 154,000 lekë, për sa përfituar më tepër për kualifikime.

Vazhdimisht

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit për likuidimin e dietave me jashtë vendit ishin likujduar më tepër në shumën 910 euro, të përfituara në dy raste nga 8 punonjës, në kundërshtim me pikën 13/a të VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “*Trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit*”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.22, datë 10.07.2011. **Për këtë është rekomanduar që:**

Mbështetur në nenin 27, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Për Kodin e Punës” me ndryshimet e mëvonshme, të bëhet ndalesa për të mundësuar arkëtimin e shumës 910 euro, për sa përfituar më tepër nga 8 punonjës të institucionit, për shpenzime për udhëtime jashtë shtetit. Të bëhen rregjistrimet kontabël që do të mundësojnë transparencën e këtij transaksioni.

Brenda 31.12.2014

KONTROLI I LARTË I SHTETIT